



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; Fax: 2268142

Nr. 100/3 Prot.

Tiranë, më 18.04.2017

**V E N D I M**

**Nr. 87, datë 18.04.2017**

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr. 22, datë 10.02.2017"***

Në mbështetje të kompetencës së parashikuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në përfundim të procedurës së verifikimit,

**VËREJ SE :**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 22, datë 10.02.2017, "Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 81, datë 19.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Mallakastër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim", mbi bazën e Programit të Verifikimit nr. 100/1 prot., datë 10.02.2017, ka vendosur kryerjen e procesit të kontrollit të akteve të emërimit, të cilat janë marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për respektimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për periudhën nga data 27.04.2016 (momenti i përfundimit të mbikëqyrjes së realizuar më parë në këtë institucion) e në vazhdim.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Mallakastër nga grupi i inspektorëve, i autorizuar për këtë qëllim, të cilët u paraqitën në këtë institucion, në datën 13.02.2017.

Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni, me shkresën nr. 100/2 prot., datë 10.02.2017, "Njoftim për fillimin e verifikimit", dhe më tej u administruan:

- Struktura dhe organika e institucionit e miratuar me Vendimin nr. 155, datë 12.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, “Për miratimin e strukturës organizative dhe paga përkatëse për Bashkinë Mallakastër dhe Njësitë Administrative për vitin 2016”.
- Listëpagesat e punonjësve të institucionit për periudhën maj 2016 - janar 2017.
- Aktet e emërimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kontratat e punës në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Verifikimi është realizuar për periudhën që fillon nga momenti i mbikëqyrjes që është kryer më parë në këtë subjekt, deri në datën 24.02.2017, dhe në përfundim rezultoi se :

Në këtë periudhë, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, në 2 raste janë emëruar punonjës nëpërmjet akteve të emërimit të përkohshëm apo kontratave të përkohshme të punës në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për emërimet e punonjësve, në pozicionet e mëposhtme:

1. \*\*\*\*\* me pozicion “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve”, emëruar në detyrë me aktin nr. 204, datë 18.08.2016, pika 1;
2. \*\*\*\*\* me pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkivi dhe IT”, emëruar në detyrë me aktin nr. 204, datë 18.08.2016, pika 2;

Komisioneri vlerëson se duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, gjë që në vështrim të nenit 108, pikat i,ii) të germës a), dhe germës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, në pozicion pune pjesë e shërbimit civil është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Mallakastër, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bëjë anulimin e akteve administrative të cituara më sipër.

Në këto kushte, bazuar në nenin 113, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, anulimi i aktit ka pasoja edhe për të shkuarën dhe për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, duhet që gjithë procedura për plotësimin e këtyre

pozicioneve të punës, të fillojë nga e para, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të anulojë pikat 1 dhe 2, të aktit administrativ nr. 204, datë 18.08.2016, që emëron në detyrë respektivisht punonjësit:
  - ✓ \*\*\*\*\*; (pika 1, e aktit), në pozicionin “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve”, pranë Bashkisë Mallakastër;
  - ✓ \*\*\*\*\*; (pika 2, e aktit), në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkivi dhe IT”, pranë Bashkisë Mallakastër.
2. Njësia përgjegjëse të hartojë planin e punës së pranimeve në shërbim civil për vitin 2017, duke përfshirë pozicionet e punës më sipër dhe pozicionet e punës të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të cilat janë evidentuar dhe trajtuar më parë nga Komisioneri në vendimin nr. 81, datë 19.07.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334 prot., datë 18.04.2016” dhe që njësia përgjegjëse nuk i ka plotësuar ende me anën e procedurave të konkurrimit.
3. Pozicionet në fjalë, duhen shpallur si të lira dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.
4. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përmbush rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të

*ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*

5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.
8. Të njoftohet për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**